

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN E LISBONËS PËR MBROJTJEN E EMËRTIMEVE TË ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN E TYRE NDËRKOMBËTAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Marrëveshja e Lisbonës, që propozohet për aderim nëpërmjet këtij projektligji, mundëson mbrojtjen ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës në vendet anëtare të saj, përmes një regjistrimi të vetëm në zyrën ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), në Gjenevë.

Ajo është hartuar në përgjigje të nevojës për një sistem ndërkombëtar që do të lehtësonte mbrojtjen e një kategorie të veçantë të treguesve gjeografikë, siç janë “emërtimet e origjinës” në vende të tjera, përveç vendit të origjinës, e ngjashme kjo me sistemin e Madridit për mbrojtjen ndërkombëtare të markave (hyrë në fuqi në Shqipëri në vitin 2003) dhe me sistemin e Hagës për mbrojtjen ndërkombëtare të disenjove (hyrë në fuqi në Shqipëri në vitin 2007).

Sipas nenit 180/b, të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008, “Për Pronësinë Industriale”, të ndryshuar, mbrojtja ndërkombëtare për treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës mund bëhet nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve dypalëshe për mbrojtjen e ndërsjellë ose marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare do të ishte më i favorshëm për mbajtësit e të drejtave mbi emërtimet e origjinës, pasi me anë të një aplikimi të vetëm do të mund të shkurtohet kohë dhe kosto për mbrojtje në 28 shtetet anëtare (aktualisht), përfshirë edhe vendet fqinjë, si: Greqia, Maqedonia, Mali i Zi dhe Italia.

Sipas nenit 2 (1), të marrëveshjes, “emërtim origjine” nënkupton emërtimin gjeografik të një vendi, rajoni ose lokaliteti, i cili shërben për të përcaktuar një produkt me origjinë nga këto vende, cilësia ose karakteristikat e të cilit i atribuohen ekskluzivisht ose në thelb mjedisit gjeografik, duke përfshirë faktorët natyrorë dhe njerëzorë. Pra, këto janë produkte që i kanë fituar karakteristikat (për shembull, karakteristikat fiziko kimike/organoleptike/biologjike/mikrobiologjike etj.) nga ndërthurja e faktorëve

natyrorë (për shembull, tipi i tokës, gjeografia, klima/mikroklima, vegjetacioni etj.) me ato njerëzorë (për shembull, njohuritë specifike mbi teknikat e përpunimit, metodat e prodhimit të produkteve etj.) në vendin e origjinës.

Produkte të tilla të certifikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale janë mish i kecit të Hasit, boronica e bjeshkëve kuksiane dhe të Tropojës, gështenja dhe mjalti i gështenjës së Malësisë së Madhe, gështenja dhe mjalti i gështenjës së Tropojës.

Shqipëria është një vend që ka shumë produkte të kësaj natyre, të cilat duhen identifikuar dhe nxitur për t'u certifikuar, pasi regjistrimi kombëtar, e më tej ai ndërkombëtar, ndikojnë në rritjen e vlerës së këtyre produkteve tradicionale, në gjallërimin e zonave rurale, në ruajtjen e biodiversitetit, të trashëgimisë kulturore dhe gastronomike dhe ofrojnë mundësinë e njohjes në tregjet e huaja të produkteve karakteristike shqiptare.

Këto kushte favorizuese vlejnë gjithashtu edhe për subjektet e huaja, të cilat, duke e pasur emërtimin e origjinës të mbrojtur në Shqipëri, gjenden në një klimë më të sigurt të ushtrimit të biznesit të tyre dhe do të mund të pasurojnë tregun vendas me produkte me karakteristika unike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji i hartuar nuk është planifikuar në programin analitik të akteve dhe dokumenteve të tjera politike për vitin 2018.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në përputhje të plotë me nenet 81, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Bashkimi Evropian, si një organizatë shumë e rëndësishme, konsiston në adoptimin e standardeve evropiane dhe në mbrojtjen e vlerave në legjislacionet kombëtare, çka mund të konsiderohet si proces i evropianizimit. Ndër prioritetet e këtij procesi përfshihet edhe mbrojtja e emërtimeve të origjinës.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Marrëveshja e Lisbonës është një marrëveshje e veçantë nën nenin 19 të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale (e miratuar në Paris, më 20 mars 1883, hyrë në fuqi në Shqipëri më 4 tetor 1995). Çdo vend anëtar i kësaj konvente mund të aderojë në marrëveshjen e Lisbonës dhe të bëhet pjesë e Asamblesë së Unionit të Lisbonës, union që ka autoritetin për të modifikuar rregulloret.

Kjo marrëveshje është nënshkruar në vitin 1958, është rishikuar në Stokholm në vitin 1967 dhe është amenduar në vitin 1979.

Marrëveshja ka 18 nene që, në mënyrë të përmbledhur, përmbajnë përkufizime, për çfarë sigurohet mbrojtja, procedurën për mbrojtjen ndërkombëtare, detyrat e Asamblesë së Unionit, informacion për buxhetin e Unionit dhe mënyrën e ratifikimit e aderimit.

Regjistrimi ndërkombëtar i emërtimeve të origjinës bëhet nga Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale (WIPO), në Gjenevë, me kërkesë të autoritetit kompetent të shtetit kontraktues.

Kjo Zyrë mban Regjistrin Ndërkombëtar të Emërtimeve të Origjinës dhe njofton formalisht shtetet e tjera kontraktuese për regjistrimin. Gjithashtu, Zyra i publikon ato në buletin zyrtar të sistemit të Lisbonës.

Një shtet kontraktues mund të deklarojë brenda një viti nga marrja e njoftimit për regjistrim që nuk mund të sigurojë mbrojtjen e emërtimeve të origjinës në territorin e tij, duke dërguar një deklaratë refuzimi bashkë me bazat përkatëse të refuzimit.

Që nga viti 2010, shtetet kontraktuese kanë mundësinë të lëshojnë një deklaratë për pranimin e mbrojtjes, duke përmirësuar kështu komunikimin në lidhje me statusin e regjistrimeve ndërkombëtare ndërmjet vendeve anëtare.

Aktualisht janë 28 shtete anëtare të marrëveshjes, përkatësisht: Algjeria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Burkina Faso, Kongo, Kosta Rika, Kuba, Republika Çeke, Korea, Franca, Gaboni, Gjeorgjia, Haiti, Hungaria, Irani, Israeli, Italia, Meksika, Mali i Zi, Nikaragua, Peru, Portugalia, Republika e Moldovasë, Serbia, Sllovakia, Togo, Tunisia dhe Maqedonia.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Pronësisë Industriale.

VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, si institucion publik jobuxhetor, që regjistron, administron dhe promovon objektet e PI-së dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë. DPPI-ja është institucioni përgjegjës për ndërmarrjen e nismave ligjore në fushën e njohjes dhe administrimit të të drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Buxheti për këtë marrëveshje miratohet nga Zyra Botërore e Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe për dyvjeçarin 2018-2019 nuk parashikon të ardhura për vendet anëtare.

Gjatë dyvjeçarit të mëparshëm 2016-2017, Sistemi i Lisbonës (që përfshin marrëveshjen e Lisbonës dhe aktin e saj të Gjenevës) ka gjeneruar një deficit të ardhurash, deficit, i cili është eliminuar kryesisht nëpërmjet kontributeve të vendeve anëtare dhe një huaje të marrë nga rezervat e unioneve të tjera të WIPO-s që bazohen në kontributet e shteteve anëtare.

Kontributi që DPPI-ja duhet të paguajë, nëse aderohet në marrëveshjen e Lisbonës, varet nga një sërë faktorësh. Konkretisht, do të merret parasysh shuma e deficitit të parashikuar gjatë dyvjeçarit, nëse ka, numri i vendeve anëtare në marrëveshje, klasa e kontributeve të cilës i përket Shqipëria, si edhe mënyra se si vendet anëtare të Unionit të Lisbonës vendosin të përdorin kontributet.

Në komunikimin që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale ka pasur me WIPO-n, është informuar se Malit të Zi, i cili gjendet në të njëjtat kushte dhe në të njëjtën klasë kontributesh me Shqipërinë, i është caktuar për 2-vjeçarin 2016/2017 detyrimi prej rreth 5 200 frangash zvicerane.

Në rast aderimi në këtë marrëveshje, Shqipëria nuk preket nga asnjë deficit i krijuar para anëtarësimit, por do të paguajë detyrimet që rrjedhin nga fakti se ky sistem rezulton ende i paqëndrueshëm financiarisht.

KËSHILLI I MINISTRAVE

